



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KORÇË  
KRYETARI

Nr. 1521 prot.

Korçë më, 25 / 02 / 2019

**URDHËR**

Nr. 122 , datë 25 / 02 / 2019

**Mbi subjektet që do të liçencohen në linjat e rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve të Bashkisë Korçë**

Pas shqyrtimit dhe miratimit të relacionit të paraqitur nga Komisioni Vlerësues në transportin e udhëtarëve në linja të rregullta rrethqytetëse, të datës 21.02.2019, bazuar në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15, neni 19; ligjin nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 64, pika a; udhëzimin nr. 5627, datë 18.11.2016, i Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, "Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit", i ndryshuar, neni 11, pika 7/a;

**URDHËROJ:**

1. Subjekti fitues në konkursin e zhvilluar prej 04.02.2019-18.02.2019, "Për përzgjedhjen e subjektit / subjekteve, që do të liçencohen në linjat e rregullta rrethqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve të Bashkisë Korçë", në të cilat nuk ka operator të liçencuar, do të jetë subjekti "Niko Pelo", me NUIS L84709001J, me autobusët me targa AA 782 XD dhe AA 577 JU, në linjën Mborje-Korçë-Mborje.
2. Të vijohet më tej me procedurën e liçencimit për këtë subjekt, në linjën Mborje-Korçë-Mborje.
3. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Territorit.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi  
N. Lika

Drejtorja e Përgjithshme  
Juridike  
A. Dishnica

KRYETARI  
Sotiraq Filo

